

VENDIM
Nr. 399, datë 23.9.2019

**PËR HAPJEN E PROCESIT, PËR SHPREHJEN E INTERESIT, PËR T'U
PËRZGJEDHUR SI KANDIDAT QË DO T'I PROPOZOHEK KUVENDIT TË
SHQIPËRISË PËR T'U ZGJEDHUR NË POZICIONIN E ANËTARIT TË
KOMISIONIT TË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS**

Presidenti i Republikës, pas administrimit të njoftimit nga Kuvendi i Shqipërisë nr. 3092/1 prot., datë 13.9.2019, se mandati 5-vjeçar i zotit Eduard Ypi, si anëtar i Komisionit të Konkurrencës, përfundon në datën 30.10.2019, në mbështetje të nenit 21, pika 3/a, të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar, si dhe me vullnetin për realizimin e një procesi objektiv e transparent për të siguruar përzgjedhjen e një kandidature me integritet të lartë moral dhe profesional të përshtatshme për këtë pozicion,

VENDOSI:

1. Hapjen e procesit për çdo të interesuar që të shprehë interesin për të qenë kandidat për pozicionin e anëtarit të Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës, që do të zgjidhet nga Kuvendi i Shqipërisë, me propozim të Presidentit të Republikës.
2. Shpallja e këtij procesi dhe publikimi sipas tekstit bashkëlidhur, të bëhet menjëherë në faqen zyrtare të internetit të Institucionit të Presidentit të Republikës dhe në mjetet e informimit publik.
3. Afati i publikimit në faqen zyrtare të institucionit dhe i paraqitjes së shprehjes së interesit, shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm, do të jetë nga data 23 shtator 2019 deri në datën 3 tetor 2019, ora 14:00.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm të nxjerrë aktet e nevojshme për procedurën e administrimit të dokumentacionit për këtë proces.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

NJOFTIM
Nr. 3325/1, datë 24.9.2019

**PËR HAPJEN E PROCESIT, PËR SHPREHJEN E INTERESIT,
PËR T'U PËRZGJEDHUR SI KANDIDAT QË DO T'I PROPOZOHEK KUVENDIT TË
SHQIPËRISË PËR T'U ZGJEDHUR NË POZICIONIN E ANËTARIT TË
KOMISIONIT TË KONKURRENCËS NË AUTORITETIN E KONKURRENCËS**

Presidenti i Republikës, pas administrimit të njoftimit nga Kuvendi i Shqipërisë nr. 3092/1 prot., datë 13.9.2019, se mandati 5-vjeçar i zotit Eduard Ypi, si anëtar i Komisionit të Konkurrencës, përfundon në datën 30.10.2019, në mbështetje të nenit 21, pika 3/a, të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar, si dhe me vullnetin për realizimin e një procesi objektiv e transparent për të siguruar përzgjedhjen e një kandidature me integritet të lartë moral dhe profesional të përshtatshme për këtë pozicion, ka vendosur:

Hapjen e procesit për çdo të interesuar, që të shprehë interesin për të qenë kandidat për pozicionin e anëtarit të Komisionit të Konkurrencës në Autoritetin e Konkurrencës, që do të zgjidhet nga Kuvendi i Shqipërisë, me propozim të Presidentit të Republikës.

Në zbatim të nenit 21, të ligjit nr. 9121/2003, anëtarët e Komisionit të Konkurrencës zgjidhen nga Kuvendi, me kandidatura të ndryshme, ku një anëtar propozohet nga Presidenti i Republikës. Anëtar i Komisionit të Konkurrencës mund të zgjidhet kandidati që plotëson kushtet e parashikuara në ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar.

Presidenti i Republikës fton:

Çdo person të interesuar që plotëson kushtet dhe kriteret e parashikuara në ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, që të marrë pjesë në këtë proces publik e të shprehë interesin për të qenë kandidat për Anëtar të Komisionit të Konkurrencës, të paraqesë pranë Institucionit të Presidentit të Republikës dokumentacionin si më poshtë:

- Kërkesën për shprehjen e interesit;
- Jetëshkrimin në gjuhën shqipe me të dhënat e plota të kontaktit;
- Kopje të noterizuar të dokumentacionit shoqërues që vërteton përmbushjen e kushteve dhe kriterëve për t’u zgjedhur në këtë pozicion, të përcaktuara në nenin 20, të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, si:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë vjetërsi pune në profesion jo më pak se 15 vjet;
- Të jetë, prej jo më pak se 5 vjetësh, pjesëtar i trupit akademik universitar ose të mbajë titull apo gradë shkencore në fushën e ekonomisë a të drejtësisë, specialiteti “E drejtë civile/administrative”;
- Të mos jetë larguar nga puna ose nga shërbimi civil me masë disiplinore.

Kërkesa për shprehje interesi dhe dokumentet shoqëruese mund të dorëzohet me postë ose drejtpërdrejt në mjediset e selisë së Presidentit, në adresën: Institucioni i Presidentit të Republikës, bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1, Tiranë, Kodi Postar 1001.

Afati i paraqitjes së shprehjes së interesit, shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm, do të jetë deri në datën 3 tetor 2019, ora 14:00.

Pas administrimit të dokumentacionit, lista e personave, të cilët kanë shprehur interesin do të bëhet publike në faqen zyrtare të Institucionit të Presidentit të Republikës.

Kandidatit/ëve të përzgjedhur do t’u kërkohej paraqitja e dokumentacionit shtesë si më poshtë:

- Formulari i vetëdeklarimit, i plotësuar dhe i nënshkruar sipas përcaktimeve të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

- Formulari i aplikimit, i plotësuar “Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta”, në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 29, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

- Vetëdeklarimi i aplikantit se nuk ndodhet në kushtet e pengesës ligjore të papajtueshmërisë së funksionit sipas përcaktimeve të nenit 22, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar.

Propozimi, që Presidenti i Republikës do t’i përcjellë Kuvendit të Shqipërisë, do të publikohet në faqen zyrtare të institucionit.